



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**

**PËR**

**MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË**

**MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**Tiranë, Shtator 2018**

## RAPORT

### **Për mbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrin nr. 85, datë 09.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 6, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrin më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Matilda Idrizaj, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe Ledina Zhupa, Inspektore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislationit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit; aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, u përpunuan të dhënat dhe u përgatit raporti i monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si më poshtë:

#### **Metodologjia e monitorimit**

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u organizua një takim dhe bashkëbisedim, me zj. Inxhi Buzi, me detyrë “Përgjegjës i Shërbimeve të Përgjithshme”, i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,

me të cilën u diskutua mbi objektin dhe drejtimet e procesit, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të punës për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësi \*\*\*\*\*, i cili kryen detyrën “*Specialist*”, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit.

- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: Vendimi nr. 509, datë 13.09.2017, i Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”; Struktura e vjetër, miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.03.2015, i Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit*”, i ndryshuar; Struktura aktuale, miratuar me urdhrin nr. 165, datë 05.10.2017, i Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”; Listëpagesa dhe listëprezenca e punonjësve pjesë e shërbimit civil, për muajin shtator 2017; Listëpagesa dhe listëprezenca e punonjësve pjesë e shërbimit civil, për muajin janar 2018; Urdhri nr. 104/1, datë 09.10.2017, i Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”; Vendimet nr. 6497 prot., datë 10.11.2017, nr. 6497/64 prot., datë 17.11.2017 dhe nr. 6497/80, datë 22.11.2017, i Komisionit të Ristrukturimit, “*Për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit*”, si dhe dokumentet të cilat materializojnë procedurën e ndjekur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për rastet e largimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit.

### **Përmbajtja e raportit**

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, rezultoi se, është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror. Nga ky proces, u shkrinë 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave iu bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin par zgjedhjeve, në 13 ministri.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, rezultoi se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, aktualisht funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 165, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit*”, i cili ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e Ministrisë së Mjedisit, miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.03.2015, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit*”.

Nga aktet e mësipërme, verëhet se, funksionet dhe struktura e Ministrisë së Mjedisit, janë përfshirë në strukturën dhe funksionet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Ky proces i përthithjes është parashikuar në përmbajtjen e vendimit nr. 509, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”, i cili në pikën 4 të tij, përcakton se: “**Vendimi nr. 945, datë 09.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”, shfuqizohet**”.

Në zbatim të pikës 2 dhe 3, germa “ç”, të vendimit nr. 509, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, rezulton se në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është përfshirë edhe komponenti i “turizmit”, ku shprehimisht përcaktohet se:

2. *“Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin e politikave për turizmin;*
3. *Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike...”*

Referuar vendimit nr. 835, datë 18.09.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, i ndryshuar (shfuqizuar), komponenti i zhvillimit të “Turizmit”, ka qenë kompetencë e ish ministrisë MZHETTS. Ky funksion, sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 106, datë 24.06.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, i ndryshuar (shfuqizuar), ushtrohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, e ministrisë në fjalë.

Për pasojë, për sa është arsyetuar më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila është subjekt i këtij monitorimi, ka kaluar në proces ristrukturimi, për shkak të ndryshimit të misionit dhe mënyrës së organizimit të këtij institucioni. Për këtë arsye, në këtë proces ristrukturimi janë marë në shqyrtim jo vetëm nëpunësit e ish Ministrisë së Mjedisit, por edhe nëpunësit që ishin pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Turizmit, në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

#### **I. Situata e pozicioneve të shërbimit civil, para momentit të ristrukturimit të institucioneve.**

Për sa është arsyetuar në përmbajtje të këtij raport monitorimi, rezulton se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka kaluar në proces ristrukturimi si pasojë e shkrirjes së ish-Ministrisë së Mjedisit me Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit dhe Turizmit në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Para momenti të ristrukturimit, situata e shërbimit civil, paraqitej si më poshtë:

##### **➤ *Struktura dhe organika e ish Ministrisë së Mjedisit***

Ministria e Mjedisit, funksiononte mbi bazën e strukturës së miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.03.2015, të , të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit”, i ndryshuar. Sipas kësaj strukture, rezulton se, institucioni në fjalë ka pasur

104 pozicione pune, prej të cilave 77, ishin pjesë e shërbimit civil. Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, 77 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në ish- Ministrinë e Mjedisit, paraqiten si më poshtë:

- Nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues, 3 pozicione pune, ose 4 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve,
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm” – kategoria e pagës I-a;
  - 2 “Drejtor i Përgjithshëm” – kategoria e pagës II-a;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, 8 pozicione pune, ose 11 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie” – kategoria e pagës II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, 19 pozicione pune, ose 25 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin:
  - 11 “Përgjegjës Sektori” - kategoria e pagës III-a;
  - 7 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a/1;
  - 1 “Krye analist i ZIMEK” – kategoria e pagës III-a;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, 47 pozicione pune, ose 60 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 33 “Specialist/kategoria e pagës III-b”;
  - 12 “Specialist/kategoria e pagës IV-a”
  - 2 “Specialist/kategoria e pagës IV-b”.

Rezulton se, para miratimit të strukturës së re, në strukturën e ish Ministrisë së Mjedisit kanë qenë 7 pozicione të lira pune.

➤ ***Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit, në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes***

Drejtorja e Përgjithshme për Zhvillimin e Turizmit ka qenë njësi organizative e strukturës së ish Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, miratuar me urdhrin nr. 106, datë 24.06.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes”, i ndryshuar. Sipas kësaj strukturë, rezulton, se kjo njësi organizative ka pasur në përbërje të saj 19 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Në referencë të përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, 19 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil të kësaj njësie organizative, paraqiten si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, **1** pozicione pune, ose **5 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i cili i përket pozicionit “*Drejtor i Përgjithshëm*”- kategoria e pagës II-a;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, **3** pozicione pune, ose **16%** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*” – kategoria e pagës II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **1** pozicion pune, ose **5 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përket pozicionit “*Përgjegjës Sektori*” – kategoria e pagës III-a;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, **14** pozicione pune, ose **74 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen si më poshtë:
  - 7 “*Specialist*” – kategoria e pagës III-b;
  - 7 “*Specialist*” – kategoria e pagës IV-a.

Nga këqyrja e akteve të vëna në dispozicion, rezulton se para momentit të ristrukturimit, në këtë njësi organizative kanë qenë 3 pozicione pune të lira.

## **II. Situata aktuale e pozicioneve të shërbimit civil, sipas strukturës së re të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Aktualisht, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit funksion mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 165, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”. Sipas kësaj strukturë, rezulton se institucioni në fjalë, në momentin e verifikimit ka gjithsej 132 pozicione pune, nga të cilat:

- **8** pozicione pune, janë funksione politike;
- **14** pozicione pune, janë funksione mbështetëse;
- **110** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil;

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, **110** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ndahen si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **5** pozicione pune, ose **4 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 1 “*Sekretar i Përgjithshëm*”;
  - 4 “*Drejtor i Përgjithshëm*”;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **13** pozicione pune, ose **12 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”;

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë **15** pozicione pune, ose 14 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 13 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a;
  - 2 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a/1
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, janë **77** pozicione pune, ose 70 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 43 “Specialist” – kategoria e pagës III-b;
  - 12 “Kryetar i Degës Territoriale të Shërbimit Turistik” – kategoria e pagës III-b;
  - 20 “Specialist” – kategoria e pagës IV-a;
  - 2 “Specialist” – kategoria e pagës IV-b.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës aktuale, krahasuar me strukturën e mëparshme të Ministrisë së Mjedisit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Turizmit, në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr. 1: Pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës së mëparshme dhe strukturës aktuale**

Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve Ministria e Mjedisit	Numri i pozicioneve Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Turistik Ish-MZHETTS	Numri i pozicioneve Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Sekretar i Përgjithshëm	1	-	1
Drejtor i Përgjithshëm	2	1	4
Drejtor Drejtorie	8	3	13
Përgjegjës Sektori III-a	11	1	13
Përgjegjës Sektori III-a/1	7	-	2
Krye analist ZIMEK III-a	1	-	-
Specialist III-b	33	7	43
Specialist IV- a	12	7	20
Specialist IV-b	2	-	2
Kryetar Dege Territoriale III-B	-	-	12
<b>Gjithsej</b>	<b>77</b>	<b>19</b>	<b>110</b>
<b>Pozicione shërbimit civil</b>		<b>96</b>	<b>110</b>

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se aparati i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka kaluar në proces ristrukturimi, në kushtet kur konstatohet plotësimi i kërkesave ligjore për të patur një proces të tillë: a) ndryshimi i misionit, b) shtim të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, ristrukturimit të pozicioneve të punës ekzistuese; si dhe ç) për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit është bërë e nevojshme një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

### **III. Procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Baza ligjore mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, i vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për këtë rast, është subjekti i cili drejton të gjithë procesin e ristrukturimit, duke respektuar të gjitha etapat që kërkon ky proces.

Për të verifikuar procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit, u kërkua nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, tërësia e materialeve shkresore, të cilat dokumentojnë realizimin e këtij procesi. Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe vlerësimit të tij në raport me kërkesat e ligjit, rezulton të jenë marra masat si më poshtë:

#### **1. Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit**

Në zbatim të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikës 15, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, rezulton se njësia përgjegjëse, DAP, ka njoftuar individualisht nëpunësit civilë, për fillimin e procedurës së ristrukturimit. Nga dokumentacioni i administruar në kuadër të verifikimit, rezulton se këto akte i janë njoftuar nëpunësve civilë në datën 13.09.2017.

#### **2. Komisioni i Ristrukturimit.**

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të strukturës dhe organikës së re, të institucionit të mbikëqyrur, njësia përgjegjëse, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit, me urdhrin nr. 104/1, datë 09.10.2017, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, me përbërje si vijon:

- ✓ \*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Performancës dhe Programeve Trajnuese, në Drejtorinë e Zhvillimit të Institucioneve të Pagave, në Departamentin e Administratës Publike – kryetar;
- ✓ \*\*\*\*\*, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit – anëtar;
- ✓ \*\*\*\*\*, Përgjegjës Sektori të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Ministrinë e Zhvillimit Urban– anëtar. (Me aktin nr. 6046/I prot., datë 13.10.2017, të Departamentit të Administratës Publike, është miratuar transferimi i saj i përkohshëm në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit);



*(Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, që është njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, \*\*\*\*\* ka filluar lejen e lindjes)*

Akti për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i është njoftuar institucionit në rristrukturim me shkresën nr. 5959/2, datë 10.10.2017, “Përcillet urdhri i Departamentit të Administratës Publike për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”.

Konstatohet se në këtë rast, është vepruar në përputhje të plotë me Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo rristrukturimit të institucionit”, ku në pikën 2, germa “a” të tij, përcakton se, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i ministrisë që po rristrukturohet;
- Drejtuesi i njësisë ku bën pjesë menaxhimi i burimeve njerëzore në ministrinë që po rristrukturohet;

Njëkohësisht, në pikën 2, germa a/1, të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet se në rastet e bashkimit/mbylljes/shkrirjes së ministrive, Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga 3 anëtarë, si më poshtë:

- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP);
- 2 përfaqësues të ministrive që preken nga procesi, të përzgjedhur nga njësia përgjegjëse (DAP) ndërmjet radhëve të nëpunësve civilë, të ministrive që preken.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është ngritur në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Numri i anëtarëve të komisionit është në përputhje me pikën 17, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ku parashikohet se “Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësia përgjegjëse sipas rastit”.

Në caktimin e drejtuesit dhe anëtarëve të komisionit, janë respektuar parashikimet e pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullat e vendosura nga udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të rristrukturimit për shkak të mbylljes apo rristrukturimit të institucionit”.

### **3. Përshkrimet e punës**

Rregullat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, miratimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, janë të përcaktuara në

pikat nga 30 deri në 40, të vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”. Ndër të tjera këto rregulla parashikojnë se përshkrimet e punës për çdo pozicion pune të strukturës së re, i bashkëlidhen propozimit për ndryshimin e strukturës, që institucioni i dërgon DAP. Më konkretisht, në shkronjën “c”, të pikës 33, është parashikuar se:

*“Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:*

*shkronja c) “Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi”. ...*

Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në mënyrë të shprehur pika 14, e kreut IV, të këtij akti nënligjor parashikon:

*“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.*

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe njësia përgjegjëse, duhet të hartonin përshkrime të reja punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil të strukturës së re.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, fillimisht ka përgatitur një ekstrakt të përshkrimeve të punës, si dhe kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi për ndryshimin e organizimit të brendshëm të institucionit, të cilin bashkë me relacionin propozues për ndryshimin e strukturës organike ia ka dërguar Departamentit të Administratës Publike. Më pas, këto materiale i janë vënë në dispozicion Komisionit të Ristrukturimit, i cili nga verifikimi i tyre ka evidentuar kriteret e veçanta për çdo pozicion pune të shërbimit civil.

Pra, në momentin e ristrukturimit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nuk kanë qenë të përfunduar formularët e përshkrimit të punës. Në momentin e kryerjes së verifikimit në këtë institucion, u konstatua se formularët e përshkrimit janë në fazën e hartimit dhe të nënshkrimit të tyre.

**Konkluzion:** Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se parregullasitë e konstatuara në procedurën e hartimit të përshkrimeve të punës janë krijuar për rrethana objektive dhe nuk janë të asaj natyre që të çenojnë procesin e

ristrukturimit, pasi rezulton se, në të gjitha rastet janë ekstraktuar kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune, sipas kushteve të reja të krijuara, të cilat i kanë shërbyer Komisionit të Ristrukturimit për të vlerësuar përmbushjen e tyre nga punonjësit aktual.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duhet të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të hartojë përshkrimet e punës sipas formatit, të përcaktuar në Lidhjen nr. 4, të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, duke përfshirë të gjithë elementët, siç janë dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duhet t’i kërkojë njësisë përgjegjëse (DAP), mendimin lidhur me përshkrimet e punës, nëse janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duhet të finalizojë këtë proces, nëpërmjet nënshkrimit të përshkrimeve të punës në ndarjen përkatëse.
- Në zbatim të pikës 18, 19 dhe 20, të aktit nënligjor të sipërcituar, përshkrimet e punës duhet të nënshkruhen njëkohësisht nga eprori direkt dhe nëpunësi për të cilin është hartuar përshkrimi i punës.
- Në përfundim të kësaj procedure, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

#### **4. Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit për sistemimin e nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur nga njësia përgjegjëse, DAP, pasi ka analizuar strukturën dhe organikën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe strukturën dhe organikën e ish-Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Turistik, pranë ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në referencë të kriterëve të veçanta të pozicioneve të punës të ministrisë në fjalë.

Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në përfundim të kësaj procedure, ka propozuar transferimin e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë prekur për shkak të ristrukturimit, proces i cili materializohet me vendimet si më poshtë:

- Vendimi nr. 6497 prot., datë 10.11.2017, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit;
- Vendimi nr. 6497/64 prot., datë 17.11.2017, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit;
- Vendimi nr. 6497/80 prot., datë 22.11.2017, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit.

Nga analiza e strukturave të mëparshme, rezulton se Ministria e Mjedisit ka pasur **77** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme Zhvillimit të Turizmit, në ish Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka pasur **19** pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Referuar listë pagesës dhe listë prezencës së muajit Shtator 2017, për të dy strukturat e mësipërme, rezulton se në këtë moment, kanë qenë në marrëdhënie pune **86** nëpunës civilë, gjithsej, të cilët gjejnë pasqyrim në tabelën si më poshtë, sipas kategorive që ata i përkasin:

*Tabela nr. 2 – Paraqitja e pozicioneve të punës, plotësuar me nëpunës civilë, në muajin shtator 2017.*

Kategoria e pozicionit	Klasa e pozicionit	Ministria e Mjedisit	Drejtoria DPZHETS (ish-MZHETTS)
TND	Sekretar i Përgjithshëm	-	
	Drejtor i Përgjithshëm	2	-
Nivel i mesëm drejtues	Drejtor Drejtorie	8	3
Nivel i ulët drejtues	Përgjegjës Sektori III-a	11	1
	Përgjegjës Sektori III-a/1	6	-
	Kryeanalist ZIMEK III-a	1	-
Nivel ekzekutiv	Specialist III-b	30	7
	Specialist IV- a	10	5
	Specialist IV-b	2	-
Numri i nëpunësve civilë		<b>70</b>	<b>16</b>
<b>Total</b>		<b>86</b>	
Vende vakante		<b>7</b>	<b>3</b>

Në referencë të dokumentacionit të administruar në kuadër të verifikimit të procesit të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, procedura e propozimit e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit, paraqitet si më poshtë:

**a) Nëpunësit e kategorisë së nivelit të lartë drejtues (anëtarë TND)**

Në lidhje me nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të lartë drejtues (*anëtar TND*), vërehet se, këta nëpunës nuk janë përfshirë në procesin e ristrukturimit, kjo për shkak të regjimit dhe statusit të posaçëm që gëzojnë ata si anëtarë të TND-së. Në nenet 27 - 33, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Kreun VII, pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, përcaktohet se, Departamenti i

Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, është organi kompetent i cili bën emërimin dhe lirimin e anëtarëve të TND-së, nga një pozicion i rregullt i nivelit të lartë drejtues.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se njësia përgjegjëse, në kuadër të ristrukturimit të institucionit të mbikëqyrur, për punonjësit e mësipërm ka vepruar si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, në ish- Ministrinë e Mjedisit. Në zbatim të Kreut VII, pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë , datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 6173/1 prot., datë 26.10.2017, ka vendosur lirimin e tij nga pozicioni i mësipërm dhe emërimin në pozicionin e rregullt “*Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit*”, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. \*\*\*\*\*, ka qenë e emëruar në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse*”, në ish Ministrinë e Mjedisit. Në zbatim të Kreut VII, pika 5, të aktit nënligjor të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 7282/2, datë 29.12.2017, ka vendosur lirimin e saj nga pozicioni i mësipërm. Aktualisht, në bazë të pikës 6, Kreut VII, të vendimit nr. 118, datë , datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, kjo nëpunëse është në pritje për t’u caktuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, duke respektuar nivelin e mëparshëm të nëpunësisë.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, Komisioni i Ristrukturimit i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me të drejtë, nuk ka trajtuar nëpunësit civil \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , të cilët janë anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues.

**b) Propozimi për transferimin e nëpunësve civilë të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues dhe të nivelit ekzekutiv**

Sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ligjshmëria e procedurës së realizuar nga Komisioni i Ristrukturimit, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësit civilë, kërkon plotësimin e dy kushteve themelore, konkretisht:

- a) Pozicioni i mëparshëm të mos ekzistojë më, ç`ka nënkupton të jetë suprimuar, shkurtuar ose riorganizuar dhe,
- b) Nëpunësi civil, pozicioni i të cilit të preket nga strukturimi, duhet të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Në referencë të dispozitës së mësipërme, si dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe*

*kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit, ka për detyrë të analizojë përshkrimet e punës së pozicioneve të ristruturuar, ndryshimin e kriterëve specifike, si dhe dosjen personale të nëpunësve në pritje të transferimit, duke evidentuar elementët kyç mbi të cilët do të bazohet vendimmarrja, të cilat janë përvoja, arsimi dhe vlerësimi i arritjeve.*

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni i Ristrukturimit propozon transferimin e nëpunësve civilë në pozicionet e lira, në përputhje me strukturën aktuale të institucionit në ristrukturim.

Vetëm në rastet e pamundësisë së transferimit të nëpunësve civilë në pozicionet që i përkasin të njëjtit sistem ministror ku nëpunësi ka qenë i emëruar, Komisioni propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë në një institucion tjetër të shërbimit civil, me kushtin që transferimi të kryhet në një pozicion të së njëjtës kategori.

Për sa është arsytuar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se numri i nëpunësve civilë, të emëruar në pozicione të nivelit të mesëm e të ulët drejtues dhe të nivelit ekzekutiv, pozicionet e të cilëve prekeshin nga procesi i ristrukturimit, është **84 nëpunës civilë**.

Komisioni i Ristrukturimit, në vendimet për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, ka shqyrtuar dhe trajtuar mundësinë e transferimit, vetëm për **81**, prej punonjësve të mësipërm, duke përjashtuar nga ky proces **3** nëpunës civilë. (*Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\**, rasti i të cilëve do të trajtohet më poshtë).

Duke vlerësuar propozimet e bëra për **81** nëpunësit civilë, konstatohet se:

- në **65** raste, është propozuar sistemimi i tyre në një vend të lirë ekzistues, brenda organikës së institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- në **12** raste, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike, është propozuar sistemimi i tyre në një vend të lirë ekzistues, në një institucion tjetër të shërbimit civil;
- në **4** raste, është propozuar lirimi nga shërbimi civil.

Me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga Komisioni i Ristrukturimit, në kuadër të riorganizimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, u analizuan dokumentet përkatëse dhe nisur nga mënyra se si ka vepruar ky mekanizëm, rastet paraqiten të grupuara si në vijim:

- o ***Rastet e propozimit për sistemim në pozicionet e lira ekzistuese, brenda organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.***

Komisioni i Ristrukturimit, në 65 raste, ka propozuar transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në pozicionet e lira, sipas strukturës aktuale të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Në referencë të vendimit nr. 6497 prot., datë 10.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, duke qenë se, disa njësi organizative (*sektorë ose drejtori*) të ish Ministrisë së Mjedisit dhe

ish Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Turizmit, në ish - Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nuk kanë pësuar ndryshim, duke ruajtur të njëjtën mënyrë organizimi, si dhe të njëjta kompetenca apo funksione, në strukturën aktuale të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nuk janë përfshirë në ristrukturim dhe si rrjedhim, Komisioni i Ristrukturimit, për **18** punonjësit të cilët kanë qenë të emëruar në këto njësi organizative, ka vijuar me nxjerrjen e akteve individuale të riemërimit, për shkak të ndryshimit të emërtesës së institucionit.

Për **47** nëpunësit e tjerë, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e tyre, në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vlerësimit të dosjes personale të nëpunësve përkatës, bazuar në sistemin e pikëzimit, sipas metodologjisë së përcaktuar në aneksin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, të ndryshuar. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit, me vendimin nr. 6497 prot., datë 10.11.2017 dhe me vendimin nr. 6497/64 prot., datë 17.11.2017, ka propozuar transferimin e nëpunësve, si më poshtë:

### **Niveli i mesëm drejtues:**

- ✓ Për **5** nëpunës të nivelit të mesëm drejtues – kategoria II-b, është propozuar transferimi në pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues – kategoria II-b.
- ✓ Për **1** nëpunës në nivelin e mesëm drejtues – kategoria II-b, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a. (*Bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\**);

**Konkluzion:** Komsioneri vlerëson se, për 5 nëpunës njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke propozuar transferimin e tyre në pozicione pune të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\* , propozimi i transferimit të tij në një pozicion civil të një niveli më të ulët, ka ardhur si rezultat i shkrirjes dhe mos ekzistencës së pozicionit të mëparshëm *Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve*, në strukturën aktuale të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Komisioni i Ristrukturimit, për shkak të pamundësisë së sistemit të këtij nëpunësi në një tjetër pozicion të nivelit të mesëm drejtues, bazuar në arsimin dhe përvojën që ky nëpunës zotëron në fushën e pyjeve dhe kullotave, ka propozuar transferimin e tij në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, transferim i cili është aprovuar prej këtij nëpunësi (*rasti do të trajtohet në vijim të këtij materiali*).

### **Niveli i ulët drejtues**

- ✓ Për **6** nëpunës të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a;

- ✓ Për 1 nëpunës të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a/1, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a/1;
- ✓ Për 2 nëpunës të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a/1, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit të ulët drejtues – kategoria III-a.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil e vlerëson të rregullt propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e këtyre nëpunësve në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori, pavarësisht se, në 2 raste, konstatohet ndryshimi i kategorisë së pagës.

Në kuptim të Lidhjes nr. 4, të vendimit nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe të nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, i ndryshuar, kategoritë e pagës III-a dhe III-a/1, i përkasin pozicioneve të kategorisë së tretë të shërbimit civil, me emërtesën “Përgjegjës Sektori” ose çdo pozicion i barasvlershëm me të. Pra, në këto raste është respektuar kërkesa e ligjit për ruajtjen e të njëjtës kategori gjatë transferimeve për shkak ristrukturimi.

#### **Niveli ekzekutiv (specialistët):**

- ✓ Për 32 nëpunës të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b, është propozuar transferimi në pozicion të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b;
- ✓ Për 2 nëpunës të nivelit ekzekutiv – kategoria e pagës III-b, është propozuar transferimi në pozicione të nivelit ekzekutiv – kategoria e pagës IV-a;
- ✓ Për 10 nëpunës të nivelit ekzekutiv - kategoria e pagës IV-a, është propozuar transferimi në pozicione të nivelit ekzekutiv – kategoria IV-a;
- ✓ Për 1 nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv – kategoria IV-b, është propozuar transferimi në pozicione të nivelit ekzekutiv – kategoria IV-b;
- ✓ Për 5 nëpunës të nivelit ekzekutiv – kategoria IV-a, është propozuar transferimi në pozicione të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, për gjithë rastet e nëpunësve të mësipërm, Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, pika 1, të ligjit për nëpunësin civil, duke propozuar transferimin e tyre në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Në 7 raste, evidentohet ndryshim i kategorisë së pagës për nëpunësit e transferuar, por në kuptim të lidhjes nr. 4, të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, pozicionet e punës me kategori page III-b, IV-a dhe IV-b, klasifikohen si pozicione të të njëjtës kategori, në nivelin ekzekutiv.



- **Rastet e propozimit për sistemim në pozicionet e lira, jashtë organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në pikën 2, germa “ç”, përcaktohet se, në rastet e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, nëse nuk ekziston mundësia e transferimit të nëpunësit civil në pozicionet e institucionit që ristrukturohet, nëpunësi mund të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, në **12** raste, Komisioni i Ristrukturimit, për nëpunësit pozicionet e të cilëve janë prekur nga ristrukturimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka propozuar transferimin e tyre në institucione të tjera të shërbimit civil, të cilat në mënyrë nominale paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Raste të propozimit për të sistemuar nëpunësit civilë në institucione të tjera të shërbimit civil

Nr.	Emër Mbiemër	Struktura e mëparshme		Pozicioni ku është transferuar		
		Emërtesa e pozicionit	Kategoria e pagës	Emërtesa e pozicionit	Kategoria pagës	Institucioni
1.	*****	Drejtor Drejtorie	II-b	Drejtor Drejtorie	II-b	Ministria e Mbrojtjes
2.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a	Përgjegjës Sektori	III-a	Ministria Infrastrukturës dhe Energjetikës
3.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a/1	Përgjegjës Sektori	III-a	Ministria Infrastrukturës dhe Energjetikës
4.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a/1	Përgjegjës Sektori	III-a	Ministria Infrastrukturës dhe Energjetikës
5.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a/1	Përgjegjës Sektori	III-a	Ministria e Rinisë, Sportit dhe Arsimit
6.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a	Përgjegjës Sektori	III-a	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
7.	*****	Kryeanalist	III-a	Përgjegjës Sektori	III-a/1	ISHM. Tregut
8.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a	Përgjegjës Sektori	III-a/1	ISHMPyjeve
9.	*****	Përgjegjës Sektori	III-a	Përgjegjës Sektori	III-a/1	Agjencia Kombëtare e Turizmit
10.	*****	Specialist	III-b	Specialist	IV-a	Drejtoria Rajonale Arsimore Tiranë
11.	*****	Specialist	IV-a	Specialist	IV-a	Agjencia Kombëtare e Turizmit
12.	*****	Specialist	IV-B	Specialist	IV-B	Agjencia Kombëtare e Turizmit

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, Komisioni i Ristrukturimit, për nëpunësit e mësipërm ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi propozimi për transferimin e tyre është bërë në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori me pozicionet ku ata kanë qenë të emëruar para ristrukturimit.

## 5. Rastet e nëpunësve civilë të cilët nuk janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit

Nga dokumentacioni i administruar, konkretisht listëpagesës dhe listëprezencës së muajit shtator 2017, u konstatua se 3 nëpunës civilë, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e miratimit të strukturës së re, nuk janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit. Duke analizuar në veçanti këto raste rezulton si më poshtë:

1. Punonjësja \*\*\*\*\*\*, ka qenë e emëruar në pozicionin “Drejtor”, i Drejtorisë së Integritimit në BE dhe Koordinimit të Projekteve, në ish – Ministrinë e Mjedisit, kategoria e pagës II-b.

Në lidhje me këtë punonjëse, rezulton se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të përhershëm të saj, me arsyetimin se ajo ka dhënë dorëheqje. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit rezulton se, kjo nëpunëse me shkresën nr. 1877 prot., datë 13.12.2017, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me aktin nr. 1877/1 prot., datë 27.12.2017, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, pasi është miratuar dorëheqja, ka vendosur lirimin nga shërbimi civil të kësaj nëpunëse.

Pavarësisht faktit se aktualisht kjo nëpunëse është liruar nga shërbimi civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkon të vërë në dukje disa parregullsi të konstatuara në këtë procedurë, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen, të cilat paraqiten si më poshtë:

Së pari, Komisioni i Ristrukturimit duhet të kishte shqyrtuar mundësinë e sistemimit

të kësaj nëpunëse në një pozicion tjetër të shërbimit civil, pasi kërkesa për dorëheqje e kësaj nëpunëse është depozituar pas përfundimit të procesit të vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit.

Së dyti, lirimimi nga shërbimi civil i nëpunëses \*\*\*\*\* është bërë nga një pozicion, i cili në momentin e nxjerrjes së aktit të lirimimit nuk ekzistonte më, për shkak të ndryshimeve strukturore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2. Punonjësi \*\*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “Drejtor”, i Drejtorisë së Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, në ish – Ministrinë e Mjedisit, kategoria e pagës II-b.

Rezulton se, punonjësi \*\*\*\*\*\*, me aktin nr. 659 prot., datë 11.02.2016, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar si nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, anëtar i TND-së. Në bazë të listëpagesës dhe listëprezencës së muajit shtator 2017, rezulton se ky nëpunës ka qenë i emëruar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në ish – Ministrinë e Mjedisit, kategoria e pagës II-b (*Mungon akti i emërimit në dosjen e personelit të këtij nëpunësi*).

Në zbatim të nenit 30, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, anëtarët e trupës së nivelit të lartë drejtues(TND), mund të emërohen në një pozicion të

kategorisë së mesme drejtuese, duke marrë pëlqimin e nëpunësit dhe të DAP-it. Në zbatim të Kreut VII, pika 7 dhe 8, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, emërimi i një anëtari të TND-së në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues, vendoset nga DAP, sipas kërkesës së institucioneve respektive.

Për sa më sipër, dhe për sa është arsyetuar në përmbajtje të këtij raporti, me të drejtë Komisioni i Ristrukturimit nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të nëpunësit \*\*\*\*\*. Kjo për faktin se, nëpunësit e kategorisë së nivelit të lartë drejtues, edhe pse të emëruar përkohësisht në pozicione të nivelit të mesëm drejtues, nuk përfshihen në procedurën e ristrukturimit, për shkak të statusit që ata gëzojnë si anëtar të TND-së.

Pas miratimit të strukturës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, rezulton se, me aktin nr. 6308/1 prot., datë 23.11.2017, të Departamentit të Administratës Publike, ky nëpunës për nevoja të institucionit, fillimisht, është emëruar përkohësisht në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues, konkretisht në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Aktualisht nëpunësi \*\*\*\*\* me aktin nr. 83/2, datë 08.01.2018, të DAP, është emëruar në një pozicion të rregull drejtues, Drejtor i Përgjithshëm, i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

1. \*\*\*\*\* ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Mbarështimit dhe Trajtimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteve, në ish – Ministrinë e Mjedisit, kategoria e pagës III-a.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të përhershëm të këtij nëpunësi në kuadër të ristrukturimit, pasi rezulton se për shkaqe të pajustificueshme ky nëpunës nuk është paraqitur në punë për më tepër se 3 muaj, fakt që evidentohet në listëprezencën e muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2017.

Në kuptim të nenit 57, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune apo më shumë, klasifikohet si shkelje shumë e rëndë e cila pas sjell largimin nga shërbimi civil, prandaj në zbatim të nenit 59, pika 2, të këtij ligji, duhej të kishte filluar ecuria disiplinore dhe Komisioni Disiplinor, duhet të kishte ndëshkuar në bazë të ligjit, këtë nëpunës.

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\* i cili në momentin e mbikëqyrjes vazhdon të mos kryejë efektivisht detyra dhe funksione, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, duhet të orientojnë procesin e ecurisë disiplinore, në përputhje me përcaktimet e neneve 57, 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 115, datë

05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”.

## **6. Transferimi i nëpunësve civilë nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.**

Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, në Kreun II, pika 20, përcakton se njësia përgjegjëse (DAP), brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit, pasi shqyrton aktet merr vendim për transferimin e nëpunësit civil. Në referencë të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse mund të vendosë kthimin e akteve kur vërteton parregullsi ligjore të dukshme, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

Në përfundim të kësaj procedure, Departamenti i Administratës Publike, njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore në lidhje me vendimmarrjen e saj, si dhe nëpunësit civilë, për aktet individuale të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit. Më tej, në zbatim të Kreut II, pika 20, të aktit nënligjor të mësipërm, nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me vendimin për sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Në lidhje me këtë moment procedural, pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, rezulton se:

- ✓ Bazuar në vendimin nr. 6497 prot., datë 10.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, në lidhje me disa propozime për transferim të përhershëm, Departamenti i Administratës Publike, me vendimin nr. 6497/1 prot., datë 10.11.2017, ka vendosur transferimin e përhershëm, për **62** nëpunës civilë.

Në lidhje me këtë vendim, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ka marrë dijeni në datën 13.11.2017 dhe me shkresën nr. 1395 prot., datë 17.11.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, “Dërgohen përgjigjet e punonjësve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit lidhur me transferimin e tyre për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ka dërguar brenda afatit 5 ditor, pranë njësisë përgjegjëse, konfirmimin për pranimin e transferimit për **61** nëpunës civilë.

Nga përmbajtja e vendimit të njësisë përgjegjëse, rezulton se në **1** (një) rast, për nëpunësin \*\*\*\*\*, në pamundësi për të gjetur një vend të lirë në të njëjtën kategori, është vendosur transferimi i tij, nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, në ish- Ministrinë e Mjedisit – kategoria e pagës II-b, në pozicionin “Përgjegjës Sektor”, i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, kategoria e pagës III-a. Në lidhje me këtë transferim, rezulton se ky nëpunës ka shprehur miratimin e tij më shkresën nr. 1213/1 prot., datë 14.11.2017.

- ✓ Njëpërmjet vendimit nr. 6497/64 prot., datë 17.11.2017, Departamenti i Administratës Publike, ka vendosur transferimin e përhershëm për **13** nëpunës civilë.
- ✓ Njëpërmjet vendimit nr. 6497/80 prot., datë 22.11.2017, Departamenti i Administratës Publike, ka vendosur transferimin e përhershëm për **3** nëpunës civilë.

Në lidhje me këto vendime, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë dijeni në datën 05.12.2017.

Nga analiza e akteve të mësipërme, rezulton se, Departamenti i Administratës Publike, për nëpunësen \*\*\*\*\*, me detyrë *“Kryeanalist i Zyrës së Informacionit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave”*, në ish Ministrinë e Mjedisit – kategoria III-a, është shprehur dy herë për transferimin e saj në një pozicion të shërbimit civil. Konkretisht, njësia përgjegjëse me vendimin nr. 6497/64 prot., datë 17.11.2017, ka vendosur transferimin e saj në pozicionin *“Përgjegjës Sektori”*, Sektori i Promocionit, Drejtoria e Marketingut dhe Promocioni, Agjencia Kombëtare e Turizmit – kategoria e pagës III-a/1. Më tej, në mbështetje të dispozitave të mësipërme ligjore, DAP ka vijuar me nxjerrjen e aktit individual nr. 6497/75, datë 17.11.2017.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 6497/80 prot., datë 22.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, rezulton se, më pas, njësia përgjegjëse ka anuluar vendimin individual për transferimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, pasi në transferimin e kësaj nëpunëseje nuk ishin marrë në konsideratë kriteret specifike të pozicionit të punës, konkretisht përvoja 3 vjeçare në fushën e marketingut dhe promocionit.

Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar edhe njëherë mundësinë e transferimit të kësaj nëpunëseje dhe në përfundim, Departamenti i Administratës Publike, ka vendosur transferimin e saj në pozicionin *“Përgjegjës Sektori”*, Sektori i Agjencive dhe Udhërrëfyesve Turistikë, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut – kategoria III-a/1.

Nga verifikimi i kryer në institucionin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për **12** nëpunësit e mësipërm, rezulton se në dosjen e procedurës së ristrukturimit, mungojnë miratimet e **6** nëpunësve civilë, konkretisht të nëpunësve: \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*. Nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore të këtij institucioni është rënë në dijeni të faktit se këta nëpunës i kanë dorëzuar personalisht këto akte, pranë Departamentit të Administratës Publike.

#### **IV.Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit**

Nga verifikimi i praktikës, që materializon vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimi, konstatohet se vetëm në **4** raste, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe IT, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, ish-Ministria e Mjedisit – kategoria III-b.

Me vendimin nr. 1863 prot., datë 12.19.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, në pamundësi sistemimi, është propozuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për punonjës të \*\*\*\*\*. Më tej, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me aktin nr. 1863/1 prot., datë 15.12.2017, ka vendosur lirimin nga shërbimi civil për këtë nëpunës. Rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\*, me shkresën nr. 114 prot., datë 10.01.2018, “*Kërkesë*”, ka ankimuar vendimin e Komisionit të Ristrukturimit për shkak se në përmbajtje të tij nuk është përcaktuar e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me eksperiencën e punës. Më tej, me shkresën nr. 114/1 prot., datë 09.02.2018, “*Kthim përgjigje*”, institucioni ka vënë në dijeni nëpunësin në fjalë se, e drejta e trajtimit sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit n. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është parashikuar në aktin për lirimin nga shërbimi civil.

Në lidhje me këtë fakt, u vërejt se, vendimi i Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin \*\*\*\*\*, nuk është shoqëruar me relacionin arsyetues, si një detyrim ligjor i përcaktuar në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë aspekt, gjë e cila shërbeu për një shqyrtim më të hollësishëm të shkakut të lirimit, nga ana e grupit të inspektimit, prej nga rezultoi:

Nga analiza e strukturës së re të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, konstatohet se në përbërje të saj nuk është parashikuar njësia organizative e njësive të teknologjisë së informacionit. Kjo për faktin se, në zbatim të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, struktura përgjegjëse TIK në institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Sipas pikës 23, të këtij akti nënligjor, punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në këto institucione, kalojnë tek AKSHI, brenda datës 23.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës.

**Konkluzion:** Për sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, vendimi i Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\*, është marrë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

2. \*\*\*\*\*, emëruar Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, ish-Ministria e Mjedisit – kategoria II-b;

Me vendimin nr. 1866, datë 12.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, në pamundësi sistemimi, ka vendosur të propozojë për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësen \*\*\*\*\*. Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se, pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve

Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit është suprimuar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve. Në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Referuar përshkrimit të punës, kriterëve të veçanta, si dhe dosjes personale të kësaj nëpunëseje, rezulton se, sistemimi i saj në këtë pozicion është i pamundur, pasi nëpunësja \*\*\*\*\*, nuk i plotëson kriteret e veçanta të vendit të ri punës.

Më tej, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të kësaj nëpunëseje në pozicione të lira në organikën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe në institucione të tjera të administratës shtetërore, dhe në përfundim të këtij procesi, Komisioni ka vendosur se transferimi i kësaj nëpunëse nuk është i mundur, pasi nuk rezultojnë pozicione vakante të kategorisë së mesme drejtuese, që t'i përshtaten të dhënave specifike të dosjes së saj.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se, vendimi i Komisionit të Ristrukturimit nuk i është komunikuar nëpunëses dhe më tej, njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me aktin nr. 1866/1 prot., datë 09.02.2018, ka vendosur lirim nga shërbimi civil, duke përcaktuar se efektet për shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe atyre financiare për këtë punonjëse fillojnë në datën 08.05.2018, periudhë kur ajo përfundon lejen e lindjes. Nga analiza e aktit të lirim nga shërbimi civil, konstatohet se për këtë nëpunëse është aplikuar e drejta e dëmshpërblimit për shkak të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Me marrjen dijeni të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, për lirim nga shërbimi civil, rezulton se kjo nëpunëse i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën e protokolluar me nr. 409 prot., datë 16.04.2018, në përmbajtje të së cilës parashtrohet se përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit, është i paligjshëm. Në përmbajtje të këtij informacioni kjo nëpunëse pretendon për shkelje procedurale në lidhje me njoftimin me shkrim për fillimin e procesit të ristrukturimit si dhe njoftimit të vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit. Njëkohësisht, pretendohet se, Komisioni i Ristrukturimit, nuk ka analizuar të dhënat individuale të kësaj nëpunëse dhe se nuk ka shqyrtuar me objektivitet mundësinë e transferimit të saj në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët.

Në kuadër të hetimit paraprak të rastit konkret, u konstatua se, kjo nëpunëse ka kundërshtuar vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesëpadi, nëpërmjet të cilës ka kërkuar *“Shfuqizimin e aktit administrativ Vendimit nr. 1866 prot., datë 12.12.2017, i njoftuar në datën 15 shkurt 2018, me anë të shkresës 1866/1 prot., datë 09.02.2018. Rregullimin e pasojave që rrjedhin nga ky shfuqizim duke rishqyrtuar mundësitë për sistemimin e paditëses”*.

3. \*\*\*\*\* , emëruar *“Përgjegjës Sektori”*, Sektori i Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, ish-Ministria e Mjedisit – kategoria III-a.

Me vendimin nr. 1865 prot., datë 12.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësin \*\*\*\*\*. Në referencë të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, rezulton se pozicioni në të cilin ka qenë i emëruar ky nëpunës është suprimuar. Në të njëjtën kohë rezulton se, për shkak të ristrukturimit numri i pozicioneve të nivelit të ulët drejtues është shkurtuar, konkretisht nga 19 në 15, pozicione. Komisioni, pas shqyrtimit të dosjes së personelit të këtij nëpunësi, ka arritur në konkluzionin se punonjësi \*\*\*\*\* nuk mund të sistemohet në pozicionet e lira të nivelit të ulët drejtues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për shkak të kriterit arsimor, pasi ky nëpunës zotëron diplomë "Master Shkencor", në shkencat inxhinierike, dega Inxhinieri Elektronike, kriter i cili nuk kërkohet në pozicionet përgjegjës sektori të institucionit në fjalë.

Në zbatim të nenit 50, pika 2, germa c, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të këtij nëpunësi në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar, duke arritur në përfundimin se nuk është gjendur ndonjë pozicion vakant në nivelin e ulët drejtues, me kategorinë e pagës III-a, që t'i përshtatet kriterëve specifike të këtij nëpunësi.

Në mbështetje të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me aktin nr. 1865/1 prot., datë 15.12.2017, ka vendosur lirim nga shërbimi civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë.

Punonjësi \*\*\*\*\* , në zbatim të pikës 35, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", ka ankimuar në rrugë administrative aktet e mësipërme duke iu kërkuar, Komisionit të Ristrukturimit, Departamentit të Administratës Publike dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (protokolluar me nr. 161 prot., datë 11.01.2018), shfuqizimin/ndryshimin dhe/ose konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të vendimit nr. 1865 prot., datë 12.12.2017, si dhe shfuqizimin e aktit nr. 1865/1 prot., datë 15.12.2017, "Për lirim nga shërbimi civil".

Njëkohësisht, rezulton se ky punonjës i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 16 prot., datë 11.01.2018, duke kërkuar rregullimin e paligjshmërisë në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit. Në përmbajtje të kësaj shkrese, nëpunësi pretendon se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka marrë në konsideratë kriteret specifike të këtij nëpunësi, gjatë vendimmarrjes për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe nuk ka vlerësuar me objektivitet mundësinë e sistemimit të tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Në vijim të ankesës, ky nëpunës pretendon se nuk është njoftuar në asnjë moment në lidhje me këtë proces dhe se aktet administrative të Komisionit të Ristrukturimit dhe të njësisë së burimeve njerëzore i janë njoftuar në datën 20.12.2017, duke mos i lejuar të ushtrojë të drejtën e ankimit të këtyre vendimeve.

Për rastin konkret u konstatua se, ky nëpunës, aktualisht i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi, duke kërkuar shfuqizimin e



akteve administrative të sipërcituara, si dhe rregullimin e pasojave juridike si pasojë e konstatimit të paligjshmërisë së këtyre akteve, për të bërë të mundur transferimin ose emërimin e nëpunësit civil \*\*\*\*\*, në të njëjtin institucion/varësi apo institucion tjetër paralel dhe me të njëjtën kategori page III-a.

4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, Drejtoria e Marketingut dhe Koordinimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes – kategoria e pagës II-b.

Me vendimin nr. 1867, datë 12.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin \*\*\*\*\*. Nga analiza e përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se, pozicioni ku ky nëpunës ka qenë i emëruar është suprimuar. Në referencë të strukturës së re të Ministrisë së Turizmit, rezulton se komponenti i “*Turizmit*”, në ish MZHETTS, mbulohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, e cila përfshin 3 drejtori në varësi të saj. Pas shqyrtimit të dosjes së personelit të këtij nëpunësi, Komisioni ka arritur në përfundimin se, sistemimi i nëpunësit \*\*\*\*\* në këto pozicione është i pamundur për shkak të përvojës së punës si dhe për shkak të kriterit arsimor, nisur nga fakti që ky nëpunës disponon një diplomë “*Master i Shkencave*”, në fushën filologjike.

Komisioni, pasi ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të këtij nëpunësi në pozicione të tjera, të nivelit të mesëm drejtues në organikën e Ministrisë së Turizmit si dhe në institucionet e tjera të administratës shtetërore, ka arsyetuar pamundësinë e sistemimit të këtij nëpunësi, pasi nuk rezultojnë vende vakante të nivelit të mesëm drejtues që t'i përshkatan të dhënave specifike të dosjes së këtij nëpunësi. Për më tepër, rezulton se edhe në institucionet e varësisë së ministrisë në fjalë, nuk janë gjetur pozicione vakante të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues.

Në mbështetje të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore të Ministrisë së Turizmit, me aktin nr. 1899 prot., datë 13.12.2017, ka vendosur lirimin nga shërbimi civil për nëpunësin \*\*\*\*\*, duke njohur të drejtën e dëmshpërblimit, në përputhje me vjetërsinë e punës. Gjatë momentit të verifikimit në këtë institucion, rezultoi se ky akt nuk i ishte komunikuar ende nëpunësit në fjalë.

Ky fakt, materializohet dhe në ankesën e datës 28.12.2017 (*protokolluar me nr. 1867/1 prot., datë 03.01.20018*), e nëpunësit \*\*\*\*\*, nga përmbajtja e të cilës rezulton se ky i fundit ka marrë dijeni vetëm në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit. Në përmbajtje të kësaj anekese, nëpunësi pretendon se vendimi i Komisionit të Ristrukturimit, për propozimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, është i padrejtë dhe vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50, pika 6, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi në rastin e nëpunësit në fjalë nuk ka shkurtime të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë.

Rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit ka marrë në shqyrtim ankesën e nëpunësit \*\*\*\*\* dhe me shkresën nr. 1867/2 prot., datë 30.01.2018, “*Kthim përgjigje*”, ka arritur në konkluzionin se, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin \*\*\*\*\*, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi kjo vendimmarrje është bazuar në

dosjen e personelit të tij si dhe në faktin që rasti nuk i plotëson kriteret specifike, të pozicioneve të punës të të njëjtës kategori, të krijuara pas ristrukturimit.

Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se, ky nëpunës aktualisht i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 1867, datë 12.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një tjetër pozicion të së njëjtës kategori si dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në punë.

### **Konkluzion:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në rastin e punonjësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , për të cilët është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, vlerëson se, kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore, pasi mosmarrëveshja administrative në lidhje me marrëdhënien e shërbimit civil në një rast ristrukturimi është objekt për tu shqyrtuar në Gjykatën Administrative si organi kompetent në këtë rast, në përputhje me nenin 41, të ligjit për nëpunësin civil.

Pavarësisht faktit se rastet e analizuara më sipër, janë duke u trajtuar nga gjykata, e cila do t'i zgjidhë ato përfundimisht në mënyrë individuale, duke u nisur nga këndvështrimi i administrimit të shërbimit civil nga subjektet dhe mekanizmat e ngarkuara prej ligjit për nëpunësin civil, gjatë riorganizimit të institucionit, në lidhje me 4 rastet e lirimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kërkon të vë në dukje disa parregullsi, të cilat konsistojnë në njoftimin e vendimit të Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, si dhe në ushtrimin e të drejtës së ankimit të këtyre akteve.

Vendimi i Komisionit të Ristrukturimit, në kuptim të përcaktimeve të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përbën një akt administrativ, i cili sjell pasoja juridike në lidhje me marrëdhënien e punës në shërbimin civil. Si rrjedhim, në zbatim dhe të nenit 41, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit duhet t'i njoftojë vendimmarrjen e tij nëpunësve civilë, interesat e të cilëve preken nga kjo veprimtari administrative. Nga sa është pasqyruar më sipër, në rastet që po diskutojmë nuk rezulton asnjë shkresë apo akt, që të materializojë procesin e njoftimit të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Në vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, përcaktohet se nëpunësi civil, ka të drejtën e ankimit të vendimit të njësisë përgjegjëse (DAP), për transferimin në një pozicion tjetër të shërbimit civil, e drejtë e cila sipas këtij akti, duhet të ushtrohet brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijeni.

Në lidhje me nëpunësin civil, për të cilin Komisioni i Ristrukturimit ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në përmbajtje të këtij akti nënligjor nuk përcaktohet shprehimisht nëse ai gëzon të drejtën e ankimit dhe rishqyrtimit të këtij vendimi, pasi në kuptim të ligjit ai gëzon të drejtën e ankimit në gjykatë për lirimin nga

shërbimi civil. Por, në analizë të Kreut V “*Dispozita të fundit*”, pika 35, të aktit nënligjor në fjalë, nëpunësi civil ka të drejtën të ankohet në *rrugë administrative* dhe gjyqësore sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Në referencë të dispozitës së mësipërme, vlerësohet se nëpunësi civil, për të cilin është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit, gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, aq më tepër kur mbi bazën e vendimit (*propozimit*) të këtij komisioni ka dalë edhe akti administrativ për lirim nga shërbimi civil, prej njësisë së burimeve njerëzore.

Nga ana tjetër, vlen të sqarohet se në rastin konkret ky akt nënligjor, nuk përcakton se cili është organi i cili duhet të shqyrtojë ankimin dhe cilat janë afatet ligjore që duhet të respektohen në këtë rast.

Në këto rrethana, në analogji me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, vlerësohet se nëpunësi mund të ankimojë aktin pranë organit që ka nxjerrë këtë akt, Komisioni i Ristrukturimit, ose pranë organit epror të organit që ka nxjerrë aktin administrativ, që në rastin konkret, sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil paraqitet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e organit që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore dhe që drejton procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore.

Në vijim të kësaj analize, ligji për shërbimin civil dhe akti nënligjor që rregullon procesin e ristrukturimit, nuk përcaktojnë se cili është afati ligjor, që njësia e burimeve njerëzore duhet të respektojë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, për të vijuar më tej me nxjerrjen e aktit për lirim nga shërbimi civil, fakt që ka sjellë parregullsi dhe mungesë koherence në përmbajtjen e akteve përkatëse.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP), Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia e burimeve njerëzore në institucionin e ristrukturuar, duhet të tregojnë kujdes në hartimin e akteve administrative të cilat ndryshojnë ose ndërpresin marrëdhënien në shërbimin civil, në njoftimin e tyre sipas afateve ligjore dhe në garantimin e të drejtës së ankimit, si një mekanizëm i përcaktuar në dispozitat në fuqi.

Për më tepër, vlen të theksohet se, njoftimi i aktit administrativ dhe materializimi i këtij procesi, është një element i rëndësishëm, i cili shënon dhe momentin e fillimit të aplikimit të së drejtës së përcaktuar në nenin 41, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: “*Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil*”.

## V. Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit së aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t'û përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit. (pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016).

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionin nën ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Më tej, njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të Kreut II, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas përcaktimeve të pikës 16, të Kreut II, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërtetohet parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohej nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (sipas pikës 20 e 21 të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve administrative në kuadër të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, duhet të respektohen edhe afatet procedurale të parashikuara për këtë rast.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij relacioni, rezulton se, procedura e shqyrtimit të mundësisë së sistemimit të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është kryer në tre faza, të cilat janë materializuar në vendimet respektive të Komisionit të Ristrukturimit dhe Departamentit të Administratës Publike.

Nga verifikimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit rezulton, se nga momenti i miratimit të aktit që ka miratuar strukturën e re, konkretisht data 05.10.2017, faza e parë e procedurës së ristrukturimit ka përfunduar në datën 10.11.2017, pra për **36 ditë**. Sipas dokumentacionit përkatës, rezulton se faza e dytë ka përfunduar në datën 17.11.2017, pra për **43 ditë** dhe faza e tretë ka përfunduar në datën 22.11.2017, gjithsej **48 ditë**.

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme.

Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtje të këtij relacioni, rezulton se ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësive organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Në rastin konkret, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, aplikimi i procesit të ristrukturimit nga aktorët e caktuar nga ligji është realizuar *brenda afateve* ligjore, duke përmbyllur këtë proces pa zvarritje.

## **KONKLUZIONE:**

Nga gjithë sa është analizuar në përmbajtje të këtij raporti, në mbështetje të dokumentacionit të administruar në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së ristrukturimit për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin dhe vlerëson se:

1. Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit për nxjerrjen e akteve administrative për propozimin e transferimit të **77** nëpunësve civilë, për të cilët pozicionet e punës u prekën si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe procedura e kryer nga Departamenti i Administratës Publike, deri në nxjerrjen e akteve administrative individuale për miratimin e transferimeve në fjalë, janë kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe

*kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit”.*

Konstatohet se, në 77 rastet e nëpunësve civilë të përfshirë në restrukturim, në asnjë rast nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar për transferimin në kuadër të restrukturimit, ç’ka provohet me dakordësinë e tyre të materializuar në deklaratat e depozituara pranë Departamentit të Administratës Publike.

2. Në lidhje me procedurën e ndjekur për lirim nga shërbimi civil, për shkak të restrukturimit, Departamenti i Administratës Publike në të ardhmen duhet të orientojë dhe asistojë subjektet që e aplikojnë këtë procedurë, në lidhje me hartimin e akteve administrative të cilat ndryshojnë ose ndërpresin marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil; njoftimin e tyre sipas afateve ligjore, me qëllim garantimin e aplikimit të së drejtës së ankimit të nëpunësit civil, të përcaktuar në nenin 41, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
3. Në lidhje me përshkrimet e punës, duhet theksuar se, finalizimi i procesit të hartimit të përshkrimeve të punës ka një rëndësi të veçantë në miradministrimin e shërbimit civil dhe në funksionimin normal të institucionit, për arsye se është pikërisht ky akt që përcakton në mënyrë të detajuar funksionet konkrete që do të kryej çdo nëpunës.

Gjithashtu, në këtë akt përcaktohet edhe shkalla e përgjegjësisë, natyra e punës, mjedisi menaxherial, shkalla e vendimmarrjes dhe përcaktime të tjera, të cilat janë të rëndësishme të njihen nga punonjësi, i cili mbulon një pozicion pune pjesë të shërbimit civil.

Hartimi i përshkrimeve të punës, është i rëndësishëm edhe në kryerjen e proceseve të tjera administrative që kërkohen nga ligji për nëpunësin civil, të tilla si procedura për vlerësimin e arritjeve në punë apo ecuritë disiplinore. Këto procedura nuk mund të realizohen normalisht në momentin kur nëpunësit nuk i janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë që ai ka.

Me qëllim përmirësimin e situatës së konstatuar, në kushtet kur aktualisht punonjësit janë pozicionuar përfundimisht në pozicionet e tyre, institucioni në mbikëqyrje, si dhe Departamenti i Administratës Publike, të orientojnë aktorët e ngarkuar me hartimin e formularit të përshkrimit të punës dhe të finalizojnë menjëherë këtë proces, duke respektuar të gjitha rregullat e përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

4. Në lidhje me disa parregullsi të evidentuara në përmbajtje të këtij raporti, vlen të theksohet se ato nuk e kanë cenuar përmbajtjen e procesit të vendimmarrjes në lidhje me transferimet e nëpunësve civilë, por janë theksuar me qëllim që të mbahen parasysh në të ardhmen.
5. Në rastin e punonjësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, për të cilët është vendosur lirim nga shërbimi civil për shkak të restrukturimit, vlerësohet se kjo

çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore, pasi mosmarrëveshja administrative në lidhje me marrëdhënien e shërbimit civil në një rast ristrukturimi është objekt për tu shqyrtuar në Gjykatën Administrative si organi kompetent në këtë rast, në përputhje me nenin 41 të ligjit për nëpunësin civil.

## **VI. DETYRA TË LËNA DHE REKOMANDIME**

Për të gjitha arsyet e parashtruara në këtë raport, në përfundim të monitorimit të procesit të ristrukturimit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkon që nga institucioni dhe Departamenti i Administratës Publike:

1. Të përfundojë menjëherë, hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas mënyrës së rregullimit të parashikuar në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike, në të cilin janë përcaktuar procedurat dhe kriteret që duhen respektuar për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse.
2. Në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\*, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, duhet të orientojnë procesin e ecurisë disiplinore, në përputhje me përcaktimet e neneve 57, 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*.
3. Njësia përgjegjëse të informojë Komisionerin për çdo veprim që do të realizohet në këtë drejtim, pasi ky proces do të ndiqet dhe asistohet nëpërmjet Sekretariatit që mbështet veprimtarinë e Komisionerit, me qëllim që të mundësohet zbatimi i ligjit për nëpunësin civil, në të gjitha drejtimet.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**